



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

A.A.nr.4/2022

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Muhamet Rexha dhe Beshir Islami, anëtar të kolegjit, në çështjen disiplinore, ndaj M. K., Gjyqtarë në Gjykatën Themelore në P. kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë (KGJK-së), për shkak të shqiptimit të masës disiplinore, duke vendosur në procedurën e ankesës kundër vendimit të KGJK-së, nr.102/2022, i datë datës 24 Shkurt 2022, në seancën të kolegjit të mbajtur me datë 19.04.2022, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e paraqitur nga M. K. - Gjyqtar në Gjykatën Themelore në P., ndërsa vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë, KGJK.nr. 102/2022, i datës 24 Shkurt 2022, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë (KGJK), me vendimin KGJK.nr. 102/2022, të datës 24 Shkurt 2022, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur: M.K., gjyqtarë i gjykatës Themelore në P., është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuar me nenin 5 paragraf 2, nënparagraf 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe pikën 5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqëtar. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur: Për këtë shkelje disiplinore, Gjyqtarit M. K. i shqiptohet sanksioni disiplinor Vërejtje Publike me Shkrim.

Kundër këtij vendimi gjyqtari në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar vendimin e goditur për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave ligjore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të ligjit dhe sanksionit disiplinor, me propozim që: Gjykata e Supreme e Kosovës, masën e shqiptuar nga KGJK, vërejtje publike me shkrim ta anuloi, si dhe inicimin e procedurës disiplinore ta pushoi.

Me përgjigje në ankesë KGJK, ka propozuar që ankesa e paraqitur të refuzohet pasi që e njëjta është tërësisht e pabazuar, ndërsa vendimin e atakuar ta lë në fuqi.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me vendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 15, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka gjetur se:

Ankesa e gjyqtarit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se KGJK, më datë 15.11.2021, ka pranuar kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor nga Autoriteti Kompetent me pretendimin se M. K. - gjyqtar në Gjykatën Themelore në P., mund të ketë kryer shkelje disiplinore nga neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nga pika 5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar. Autoriteti Kompetent ka kërkuar nga KGJK, si organ kompetent të filloj hetimin disiplinor dhe ka propozuar që ndaj të njëjtit, në rast se vërtetohet shkelja disiplinore, të shqiptohet njëra nga sanksionet disiplinore të parapara sipas nenit 7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Kërkesës së lartcekur, Autoriteti Kompetent ia ka bashkangjitur shkresat e lëndës me shenjën PKR.nr.35/15, në të cilat pretendon se ka pasur neglizhencë në vendosje të lëndës përkatëse dhe zvarritje në procedimin e lëndës si pasojë e mosveprimit të gjyqtarëve që kanë qenë të ngarkuar me këtë lëndë. Nga Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në P., janë trajtuar vetëm veprimet e gjyqtarit M. K. e jo të gjyqtarëve tjerë, pasi që i njëjti nga data 01.07.2019 është gjyqtar i Gjykatës Themelore në P. - Departamenti Special.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me vendimin KGJK.nr.323/2021 të datës 08.11.2021, ka themeluar Panelin Hetimor për lëndën disiplinore Nr.AD.KGJK/09/2021/KTHPR-AD/GJTHPR/40/21. Paneli Hetimor më datën 26.01.2022, i ka paraqitur KGJK-së, raportin me shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkeljen e pretenduar.

Pas pranimit të raportit nga Paneli Hetimor, KGJK-ja, për të shqyrtuar këtë çështje disiplinore më datën 10.02.2022, ka mbajtur seancën dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë kryesuesi i panelit hetimor dhe subjekti i hetimit disiplinor.

Paneli Hetimor duke u bazuar në Ligjin me numër 06/1-057, Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Rregullores 05/2019, Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, ka mbajtur seancën dëgjimore më datën 08.12.2021, në të cilën është ftuar subjekti i hetimit disiplinor. Paneli Hetimor më datën 22.11.2021 i është drejtuar Gjykatës Themelore në F., dhe ka kërkuar shënimet mbi ngarkesën me lëndë të gjyqtarit M. K., për periudhën kohore nga muaji Janar 2016 deri në muajin Korrik 2019.

Faktet e gjetura nga Paneli Hetimor janë se gjyqtari është ngarkuar me lëndën PKR.nr.35/15, më datën 06.03.2015 dhe seancën e parë për këtë çështje penale e kishte

caktuar më datën 02.02.2016. Për shkak se nuk ka mundur të sigurohet pjesëmarrja e të pandehurve në procedurë edhe përkundër faktit se i'u ishin dërguar ftesat, seanca nuk është mbajtur. Nga fletëdërgesa e dërguara ishte konstatuar se të pandehurit A.S. dhe G. P., nuk banojnë në adresat në të cilat i'u janë dërguar ftesat ndërsa për të pandehurin M.S. në fletëdërgesë është konstatuar se i njëjti është shpërngulur nga adresa ku ka jetuar. Nga data 02.02.2016 deri më datën 26.01.2017 gjyqtari nuk kishte ndërmarr asnjë veprim lidhur me caktimin e seancës, veprimin e dytë dhe të fundit në këtë çështje penale e kishte ndërmarr më datën 12.01.2017, kur iu ishte drejtuar Stacionit Policor në Zveçan dhe Stacionit Policor në Ferizaj. Gjyqtari nga data 15.03.2017 deri me datën 01.07.2019 ka qenë Gjyqtar Mbikëqyrës në Gjykatën Themelore në F. - Dega në Sh., ndërsa nga data 01.07.2019, ka kaluar në Gjykatën Themelore në P. - Departamenti Special.

Për të vërtetuar faktet në këtë çështje disiplinore KGJK, ka administruar dhe vlerësuar këto prova: shkresën e datës 07.10.2021 të Kryetarit e Gjykatës Supreme për Kryetarin e Gjykatës Themelore në P., shënim zyrtar PPKR.nr.35/2015 të datës 25.08.2021 shkresën e datës 25.08.2021, shkresën e datës 24.08.2021 me nr. reference GjA.nr.185/2021, shkresën e regjistrimit elektronik të lëndëve me shenjën 4, bashkangjitur me raportin në dorëshkrim të lëndëve: aktakuzën PKR.nr.35/2015, aktvendimin PPKRK.nr.43/2013 të datës 02.08.2013, propozimin për zëvendësimin e masës së paraburgimit me masën e arrestit shtëpiak PP.I-110/2013 të datës 31.07.2013, aktvendimin PPKR.nr.43/13, kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit PPI.110/2013 të datës 12.07.2012, aktvendimin e Gjykatës Themelore në F.j me numër të lëndës 2018:041269 të datës 19.02.2020, raportin e vlerësimit të performancës, transkriptin e seancës dëgjimore të datës 08.12.2021 të panelit hetimor, procesverbalin mbi paraburgimin PPKR.nr.43/13 të datës 12.07.2013, aktvendimin e Gjykatës Themelore në F. PPKR.nr.43/13 të datës 12.07.2013, vendimin e Gjykatës Themelore në F. të datës 12.07.2013 me numër të dosjes 004348/21, kërkesën për përjashtimin nga lënda 2018:041269 të datës 07.02.2020 bashkangjitur me vendimin për përjashtim, deklaratën e gjyqtarit M. K. sipas kërkesës së datës 12.10.2021 për Kryetaren e Gjykatës Themelore në P..

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë vendimin e atakuar KGJK.nr.102/2022, i datës 24.02.2022, me të cilin është konstatuar se gjyqtari M. K. është shpallur përgjegjës për shkelje disiplinore dhe i është shqiptuar sanksioni disiplinor duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

Në arsyetim të vendimit të atakuar, KGJK, ka theksuar se: pas vlerësimit të provave të administruara dhe deklaratës së subjektit të hetimit në vazhdimin e seancës dëgjimore të mbajtur më datën 24.02.2022, ka konstatuar se gjyqtari M. K., me rastin e procedimit të çështjes penale me shenjën PKR.nr.35/15, ka kryer shkelje disiplinore të përcaktuar

me nenin 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe pika 5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar.

KGJK, ka konstatuar se gjyqtari M.K. është përfshirë në shkelje disiplinore të pretenduar nga autoriteti kompetent, për shkak të mos procedimit më tutje të lëndës penale PKR.nr.35/15, për arsye se gjyqtari e kishte pranuar lëndën në fjalë me datën 06.03.2015, seancën e parë e kishte caktuar më datën 02.03.2016 ndërsa deri me datën 26.01.2017 ai nuk kishte ndërmarr asnjë veprim tjetër.

Ka theksuar se KGJK, e ka pasur parasysh se gjyqtari nga data 15.03.2017 deri me datën 01.07.2019 ka qenë i përzgjedhur si Gjyqtar Mbikëqyrës në Gjykatën Themelore në F. - Dega në Sh., ndërsa nga data 01.07.2019 ka kaluar në Gjykatën Themelore në P. - Departamenti Special. Po ashtu KGJK, ka qenë në dijeni se gjyqtari ka qenë i ngarkuar me një numër të madh të lëndëve të rënda penale, megjithatë mosndërmarrja e asnjë veprimi nga ana e gjyqtarit përveç caktimit të seancës së parë, që përfshin periudhën nga data 02.02.2016 deri më datën 01.07.2019, kur gjyqtari ka kaluar në Gjykatën Themelore në P. - Departamenti Special lidhur me lëndën me shenjë PKR.nr.35/15 sipas vlerësimit të KGJK, paraqet neglizhencë nga ana e gjyqtarit.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të vendimit të atakuar KGJK, ju ka referuar nenit 7 par.1 pika 1.2 dhe par.2 pika 2.5 nenit 5 par.2 nënpar.2.7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, e lidhur me nenin 5 paragraf 1 dhe 2 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar.

Gjykata Supreme e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Këshillit Gjyqësor të Kosovës është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që vendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë, drejt dhe në mënyrë plotë është vërtetuar gjendja faktike, si dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të subjektit hetimor - gjyqtarit, se vendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, dispozitivi i vendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e vendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. KGJK, ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për të konstatuar përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, KGJK, në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, nga e cila ka rrjedhë përgjegjësia disiplinore e gjyqtarit të pretenduar nga Autoriteti Kompetent, për çka edhe i'a ka shqiptuar sanksionin disiplinor.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e KGJK-së, sepse në bazë të provave të administruara, KGJK, në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se gjyqtari M. K. është përfshire në shkelje disiplinore të pretenduar nga autoriteti kompetent, për shkak të mos procedimit më tutje të lëndës penale PKR.nr.35/15, për arsye se gjyqtari e kishte pranuar lëndën në fjalë me datën 06.03.2015, seancën e parë e kishte caktuar më datën 02.03.2016 ndërsa deri më datën 26.01.2017 ai nuk kishte ndërmarr asnjë veprim tjetër. Mosndërmarrja e asnjë veprimi nga ana e gjyqtarit përveç caktimit të seancës së parë, që përfshin periudhën nga data 02.02.2016 deri me datën 01.07.2019, kur gjyqtari ka kaluar në Gjykatën Themelore në P. - Departamenti Special, lidhur me lëndën me shenjën PKR.nr.35/15 sipas vlerësimit edhe të kësaj gjykate, paraqet neglizhencë nga ana e gjyqtarit.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e KGJK-së, për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se:

Me nenin 5 paragraf 2 nën paragraf 2.7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, përcaktohet se: “ Shkelja e detyrave të gjyqtarit sipas këtij ligji, përfshin veprimet e mëposhtme, në qoftë se gjyqtari kryen me dashje apo nga pakujdesia e rëndë: në vazhdimësi nuk i kryen detyrat zyrtare me kohë siç kërkohet me ligj ”.

Me nenin 7 paragraf 1 të këtij ligji përcaktohet se: “ Për shkelje disiplinore, këshillat përkatës mund ti shqiptojnë gjyqtarëve dhe prokurorëve një ose më shumë nga sanksionet disiplinore në vijim: 1.1. vërejtje jopublike me shkrim; 1.2. vërejtje publike me shkrim; 1.3. zvogëlim i përkohshëm i pagës deri në 50% për një periudhë deri në një vit; 1.4. transferim i përkohshëm ose i përhershëm në një gjykatë apo prokurori tjetër të nivelit më të ultë; 1.5. propozim për shkarkim ”, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se; “ Masa disiplinore shqiptohen vetëm në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe duke marr parasysh: 2.1. numrin dhe seriozitetin e shkeljeve disiplinore të kryera nga një gjyqtar apo prokuror; 2.2. pasojat e shkeljes disiplinore; 2.3. rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore; 2.4. performanca dhe sjelljen e përgjithshme të gjyqtarit apo prokurorit dhe 2.5. sjelljen dhe nivelin e bashkëpunimit të gjyqtarit apo prokurorit gjatë procedurës disiplinore ”.

Me nenin 5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar, përcaktohet se: “ Gjyqtari mban nivel të lartë të aftësive profesionale dhe ushtron funksionin e tij në mënyrë profesionale të përgjegjshme dhe efikase ”, me paragrafin 1 të këtij neni, përcaktohet se: “ Funksioni i gjyqtarit ka prioritet kundrejt të gjitha aktiviteteve tjera të gjyqtarit ”, me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: ”Gjyqtari është i detyruar që të organizoj punën brenda orarit të punës me qëllim të shfrytëzimit të plotë dhe efikas të orarit të punës ”, ndërsa me paragrafin 5 të këtij neni përcaktohet se: “ Gjyqtari ushtron funksionin e tij në mënyrë efikase dhe të ligjshme ”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore dhe dispozitave të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar, Gjykata Supreme erdhi në përfundim se KGJK, drejt ka aplikuar të drejtën materiale dhe se është konstatuar përgjegjësia disiplinore e gjyqtarit të pretenduar nga Autoriteti Kompetent, për çka edhe i'a ka shqiptuar sanksionin disiplinor.

Gjykata Supreme, vlerëson se sanksioni disiplinor i shqiptuar nga KGJK, është në përputhje të plotë me parimin e proporcionalitetit për faktin se me rastin e vendosjes ka marr parasysh seriozitetin e shkeljes disiplinore të kryer nga gjyqtari, pasojat e shkeljes disiplinore, rrethanat në të cilën është kryer shkelja disiplinore, performanca dhe sjellja e përgjithshme e gjyqtarit si dhe sjellja dhe bashkëpunimi i gjyqtarit në procedure disiplinore, rrethana këto që kanë ndikuar gjetjen e nivelit të proporcionalitetit, në mes të shkeljes disiplinore dhe masës disiplinore, siç përcaktohet me nenin<sup>7</sup> paragrafi 2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Janë të pabazuara pretendimet ankimore se në këtë rast kemi të bëjmë me diskriminim, për arsye se nga ana e organit kompetent - Kryetarja e Gjykatës Themelore në P., janë trajtuar vetëm veprimet e gjyqtarit M. K. e jo edhe të gjyqtarëve tjerë ndërsa objekt i shqyrtimit sipas ankesës në Gjykatën Supreme ka qenë vetëm vendimi i atakuar i KGJK-së, me të cilën është konstatuar shkelja disiplinore e gjyqtarit M. K. ndaj të cilit është shqiptuar edhe sanksioni disiplinor. Kjo nuk do të thotë se ndaj gjyqtarëve tjerë siç pretendon ankuesi nuk është apo nuk do të paraqitet kërkesë për fillimin e hetimeve nga Autoriteti Kompetent.

Nga arsyet e cekura Gjykata Supreme e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e duke u mbështetur në nenin 15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË**

A.A.nr.4/2022, me datë 19.04.2022

Kryetari i kolegjit  
Rrustem Thaqi, d.v